




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL



PZAP

Raporti Vjetor 2024

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
VIZIONI	6
MISIONI	6
KORNIZA LIGJORE	6
Struktura Organizative e PZAP-it	7
Struktura organizative Sekretariatit të PZAP-it.....	9
Zyra e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it.....	9
Departamenti Ligjor	9
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	10
ORGANOGRAMI I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA – (PZAP)	10
Përfaqësimi gjinore dhe i komuniteteve në kuadër të PZAP	11
Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të Sekretariatit të PZAP-it.	11
ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA	12
PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL I PZAP-IT	12
Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut - 08 Maj 2024	12
Takimi me ekipin e organizatës amerikane Navanti – USAID	13
Takimi i PZAP me OSBE	13
Takimet e PZAP-it me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.....	13
PUNËTORITË E PZAP-IT.....	14
Punësoria e PZAP-it me Misionin e OSBE-së në Kosovë.....	14
AKTIVITETET E SEKRETARIATIT	15
Ankesat e Paraqitura Kundër Vendimeve të KQZ-së, në PZAP	17
Ankesat e Paraqitura Kundër Vendimeve të PZAP-it, në Gjykatën Supreme të Kosovës	20
Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve.....	20
Trajnimet e zyrtarëve të Sekretariatit.....	21

Zhvillimi i procedurave të rekrutimit	21
Aktivitetet nga fusha e prokurimit.....	22
Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara	23
BASHKËPUNIMI I PZAP-IT, ME AKTERËT E TJERË TË ZGJEDHJEVE.....	23
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	23
Kërkesat për Qasje në dokumente publike.....	24
Komunikimi me media dhe informimi publik	24
BUXHETI DHE FINANCAT	25
Shpenzimet buxhetore.....	27
Pagat dhe shtesat.....	29
Mallrat dhe shërbimet	29
Krahasimi i shpenzimeve të buxhetit përgjatë dy viteve 2023-2024.....	31
TË HYRAT E PZAP-IT.....	32
Rekomandimet e auditimit të pasqyrave financiare të PZAP-it.....	33
Shërbimet e përgjithshme	35
SFIDAT	37

LISTA E SHKURTESAVE

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
SPZAP – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
LZP – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL – Ligji për Zgjedhjet Lokale
ZYRA - Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike
SP- Subjekti Politik
QNR – Qendra për Numërimin e Rezultateve
SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SIMBNJ/HRMIS – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SMVP – Sistemi i Menaxhimit të Vijueshmërisë në Punë
SMA – Sistemi për Menaxhimin e Ankesave
ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit
AQP - Agjencia Qendrore e Prokurimit
LMFPP – Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
SNKSP - Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik
SZHMB – Sistemi i zhvillimit të menaxhimit të buxhetit
KPM-Komisioni i Pavarur i Mediave
KMSHK-Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2024, është dokumenti bazë që paraqet apo shpalosë aktivitetin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), si organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e paraqitura, që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç përcaktohet me Ligjin Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe rregullat zgjedhore.

Raporti vjetor pasqyron aktivitetet e PZAP-it, të realizuara nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2024, në të cilin përfshihet veprimtaria, sfidat dhe të arriturat e PZAP-it, gjatë kësaj periudhe.

Ky raport është dëshmi e punës së PZAP-it, që është realizuar me përkushtim dhe profesionalizëm nga ana e anëtarëve të PZAP-it, dhe stafit të administratës së Sekretariatit, siç janë puna e panelit në vendosjen e ankesave të paraqitura nga subjektet politike, rezultatet e arritura të departamenteve, aktivitetet e prokurimit, aktivitetet lidhur me çështjet e personelit, shpenzimet buxhetore, komunikimi dhe bashkëpunimi me akterët zgjedhor, të dhëna për pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it, dhe stafit të sekretariatit në konferencat dhe në punëtoritë e organizuara.

PZAP, gjatë kësaj periudhe raportuese ka realizuar objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara me Planin Strategjik të PZAP-it, Planin e Punës për vitin 2024, Planin i Veprimit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të datës 09.02.2025. PZAP, për këtë proces zgjedhor ka njoftuar/ konfirmuar me shkrim KQZ-në, lidhur me gjobat e paguara nga subjektet politike të cilat kanë aplikuar për certifikim për këto zgjedhje, dhe ka njoftuar KQZ-në, për të dhënat e personave të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrje në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve, të organizuara nga KQZ-ja.

Nga fillimi i procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, deri më datë 31.12.2024, nga subjektet politike në PZAP, janë dorëzuar katërmëdhjetë (14) ankesa, për të cilat PZAP-i, ka vendosur brenda afateve të përcaktuara ligjore.

PZAP-i, në përfaqësim të 2 (dy) gjyqtarëve dhe 6 (gjashtë) zyrtarëve të administratës së sekretariatit të PZAP-it, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve Parlamentare, që janë mbajtur më datë 08 Maj 2024, në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vizita e delegacionit të PZAP-it, u realizua nga data 07-09 Maj 2024, pas një ftese nga autoritetet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Përfaqësuesit e PZAP-it, vizituan edhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u njohën me dinamikën legjislative të këtij vendi.

Në kuadër të zbatimit të politikës së re ligjore, Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i, ka përgatitur dhe finalizuar Rregulloren Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Sekretariatit të KGJK-së, janë përgatitur Rregullore Nr. 02/2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, Rregullore Nr. 12/2024, Për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, si dhe Rregullore Nr.13/2024, për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa,

Me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 08/L-193 për vitin 2024, për PZAP-in është ndarë buxhet në shumë prej 239,917 €. Pas ndryshimeve buxhetore, me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kursime buxhetore në fund të vitit, buxheti i PZAP-it ka mbetur në shumë prej 180,307€ dhe nga ky buxhet është shpenzuar shuma prej 173,111 €, apo 96% e buxhetit përfundimtar.

PZAP-i, gjatë procesit të rregullt të planifikimit të buxhetit sipas qarkoreve buxhetore 2025/01 dhe 2025/02 ka dorëzuar dy Kërkesa për buxhet shtesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, për dy proceset zgjedhore të parapara për vitin 2025 në shumë prej 128,939€. Mirë këto kërkesa për buxhet shtesë nuk janë aprovuar dhe nuk janë përfshirë në Ligjin e Buxhetit Nr. 08/L-332 për ndarjet buxhetore për vitin 2025.

Në zbatim të rekomandimit të anëtarëve të PZAP-i, lidhur me Vendimin e KGJK-së për Aprovimin e Kërkesës, për rekrutimin e 18 pozitave (zyrtar të përkohshëm për dy procese zgjedhore), PZAP, në mungesë të buxhetit, me datën 06.12.2024, ka njoftuar Presidenten e Republikës së Kosovës dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës, për mos miratimin e buxhetit shtesë, për realizimin e mandatit ligjor për zgjedhjet e vitit 2025. Kjo kërkesë është bërë me qëllim që të sigurohet stafi shtesë për shkak të volumit të madh të punës për zgjedhjet e planifikuara të vitit 2025.

PZAP-i, ka zhvilluar procedurën e rekrutimit për Zyrtarin e TI dhe Zyrtarin e Transportit, si dhe zhvillimin e procedurës së rekrutimit për angazhimin e 10 zyrtareve të përkohshëm për Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës e Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

Po ashtu, PZAP-i, ka bërë Zhvillimin dhe Ridizajnimin e Web faqes zyrtare të PZAP-it, www.pzap-ks.org, ku është ri dizajnuar në funksionalitetin e saj, në fushën e ngarkimit dhe shkarkimit të dokumenteve dhe shkresave të tjera, si dhe në lidhshmërinë e saj me sistemin elektronik për menaxhimin e ankesave (SMA). Përmirësimet softuerikë janë bërë edhe në sistemin SMA, përmes së cilave iu është mundësuar publikut një qasje në kohën reale në statusin e ankesës dhe në ecurinë e procedurave të vendimmarrjes lidhur me ankesën konkrete. Me ridizajnim dhe azhurnim në fjalë është mundësuar një komunikim i shpejtë në mes të sistemit SMA dhe web faqes zyrtare të PZAP-it, përmes së cilit komunikim iu është mundësuar qasje e shpejtë publikut për vendimet e marra nga PZAP-i.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në Raportin e Auditimit të PZAP-it, për vitin financiar 2023, të datës 20.06.2024, ka konstatuar se Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2023, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

VIZIONI

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, është dhe synon të jetë një institucion i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ, që punon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

MISIONI

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akterët lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP, është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

KORNIZA LIGJORE

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP, në zbatim të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave të tij, bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare, për të siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, subjekteve politike, dhe akterëve tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen lidhur me kontestet zgjedhore. Vendimet e PZAP-it, janë të detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se nga ankesa e parashtruar në Gjykatën Supreme e Kosovës, vendoset ndryshe.

Korniza ligjore primare bazike, por që nuk kufizohet vetëm, PZAP, realizon mandatin e tij përmes legjislacionit si në vijim:

- *Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës,*
- *Ligjit Nr. 03/L-072, Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës,*
- *Rregullore Nr.15-2023 Për Statusin Kushtet dhe Procedurën Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa,*
- *Rregulloren Nr. 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave,*
- *Rregullore Nr. 12/2024 Për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor Për Ankesa dhe Parashtresa,*

- *Rregullore Nr. 13/2024 Për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa,*
- *Rregullore Nr. 01/2024 Për Procedurën e Rekrutimit, Pranimit, Emërimit dhe Punës Provuese për të Punësuarit në Administratën e Sistemit Gjyqësor,*
- *Rregullore Nr.02-2024 Për Klasifikimin Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën Sistemit Gjyqësor,*
- *Rregullore Nr. 04/2024 Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për një Periudhë të Caktuar në Administratën e Sistemit Gjyqësor,*
- *Rregullore Nr.03- 2024 Për Procedurën Disiplinore për Nëpunësit në Administratën Sistemit Gjyqësor*
- *Rregullore Nr.05-2024 Për Orarin punës dhe pushimet në administratën sistemit gjyqësor,*
- *Rregullore Nr. 06/2024 Për Transferimin e Nëpunësve në Administratën e Sistemit Gjyqësor,*
- *Rregullore Nr. 09/2024 Për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor,*
- *Rregullore Nr.14- 2023 Për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin e Dosjes Elektronike të Administratës Gjyqësore,*
- *Rregullore Nr.17-2023 Për Trajnimin të Punësuarve në Administratën Sistemit Gjyqësor,*
- *Rregullat Zgjedhore të KQZ-së.*

Për zbatim të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i, ka përgatitur dhe finalizuar Rregulloren për procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, formularët standard që palët do të përdorin për dorëzimin e ankesave si dhe vërtetimi me të cilin dëshmohet dorëzimi i ankesës.

Struktura Organizative e PZAP-it

Sipas Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-së, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa anëtarët emërohen nga radha e gjykatësve të Gjykatës së Apelit të cilët shërbejnë për një mandat të ripërtitëshëm prej katër (4) viteve. Në bazë të këtij ligji PZAP-i, përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtar duke përfshirë kryesuesin e PZAP-it.

Me miratimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së) Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me natyrën e punës së PZAP-it, ka miratuar akt të veçantë për kushtet dhe përvojën specifike të gjyqtarëve që mund të emërohen në PZAP.

Në rast se pozita e kryesuesit apo një anëtar i mbetet e zbrazët, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron një person në atë pozitë brenda tridhjetë (30) ditëve.

PZAP-i mund të mbledhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtar.

Me buxhetin e vitit 2024 të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka të lejuara/aprovuara 21 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 10 (dhjetë) anëtar të panelit të PZAP-it, 1 (një) Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Në bazë të Rregullores me dispozitat kalimtare të LZP-së Udhëheqësi aktual i Sekretariatit të PZAP-së, me automatizëm emërohet ushtrues i detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së deri në rekrutimin e kësaj pozite, e cila fillon pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP, ne vitin 2024 funksionoi në këtë përbërje, si vijon:

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtar të PZAP-it përfshirë edhe kryesuesin. Aktualisht janë të emëruar dhe kanë mandat tetë (8) anëtar aktiv të PZAP-it, përfshirë kryesuesin si dhe një (1) anëtar pasiv si më lartë shënuar i cili është në dorëheqje, ndërsa tre (3) pozita të anëtarëve të PZAP-it, janë të zbrazëta, të cilat duhet të plotësohen në përputhje me nenin 115 të Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

1. Zenel Leku, Kryesues i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës,
2. Kymete Kicaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
3. Hajriz Hoti, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
4. Arsim Hamzaj, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
5. Hidajete Gashi Alaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
6. Skender Çoçaj, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
7. Bujar Muzaqi, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
8. Kujtim Pasuli, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,

Për shkak të arritjes së moshës së pensionimit Shukri Sylejmani, Kryesues i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, më datë 12.03.2024, iu është ndërprerë mardhënia e punës, Adnan Konushevc, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Prishtinë, për shkak të përfundimit të mandatit të dytë më datë 01.04.2024 dhe Burim Ademi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit – Prishtinë, për shkak të përfundimit të mandatit të parë, më datë 14.10.2024, të njejtëve iu është ndërprerë mardhënia e punës si anëtarë të PZAP-it, ndërsa Franciska Zhitija-Ymeri, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit-Prishtinë, për shkak të emërimit të saj gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës, më 01.11.2024, i është ndërprerë mardhënia e punës si anëtare e PZAP-it.

Struktura organizative Sekretariatit të PZAP-it

Në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësiwe ligjore që ka, PZAP-i mbështetet nga udhëheqësi i Sekretariatit dhe zyrtarë të tjerë të cilit ofrojnë përkrahje profesionale dhe teknike për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e tij të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Organizimi i brendshëm i Sekretariatit të PZAP-it, është i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP. Sipas kësaj Rregullore, struktura e sekretariatit përbehet prej dhjetë (10) zyrtarëve, përfshi drejtorin e përgjithshëm të sekretariatit dhe dy departamenteve

KGJK, më datë 30.09.2024, ka miratuar Rregulloren Nr. 13/2024 Për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, mirëpo e njëjta rregullore nuk është zbatuar për arsye se MFPT, nuk e ka miratuar vlerësimin financiar dhe ka pasur implikime buxhetore për zbatimin e saj. Në këtë rregullore janë të parapara edhe 7 pozita të reja në SPZAP, për te cilat pozita duhet aprovim nga MFPT.

Zyra e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it

Sekretariati ndihmon PZAP-in, në ushtrimin e përgjegjësiwe dhe funksioneve të tij në pajtim me LZP. Sekretariati i PZAP-it, ka një udhëheqës të zyrës, respektivisht Drejtorin e sekretariatit i cili, nën drejtimin e Kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it. Zyrën e Drejtorit të sekretariatit e përbejnë Drejtori dhe Asistentja Ekzekutive.


Departamenti Ligjor

Ndër përgjegjësitë kryesore që ka, mbështet punën profesionale të PZAP-it dhe Sekretariatit, duke siguruar kryerjen e shërbimeve juridike, këshilluese, për të siguruar menaxhim efektiv, identifikimin e nevojave për hartimin e politikës së legjislacionit primar dhe sekondar duke siguruar respektimin e teknikave dhe standardeve, të ofroj mbështetje profesionale menaxhmentit të institucionit dhe paneleve të gjyqtareve në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, si dhe ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të duhura për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e Departamentit. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë, përfshirë Drejtorin e departamentit ligjor dhe tre (3) zyrtar të lartë ligjor, ku secili prej tyre është pjesë e njërit nga panelet e PZAP-it.

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen e burimeve materiale, ofrimin e shërbimeve administrative dhe teknike, menaxhimin e financave dhe buxhetit, Teknologjisë Informative si dhe logjistikën e PZAP-it. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë Drejtori për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Zyrtar i Teknologjisë Informative, Zyrtar i Lartë për Përkthime dhe Zyrtar për Transport.

ORGANOGRAMI I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA – (PZAP)¹




¹ Ky organogram pasqyron organizimin e brendshëm të Sekretariatit të PZAP-it, sipas Rregullore Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP. KGJK, më datë 30.09.2024, ka miratuar Rregulloren Nr.13/2024 Për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të PZAP-it, mirëpo e njëjta rregullore nuk është zbatuar për arsye se MFPT, nuk e ka miratuar vlerësimin financiar dhe ka pasur implikime buxhetore për zbatimin e saj.

Përfaqësimi gjinore dhe i komuniteteve në kuadër të PZAP

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it, deri në fund të këtij viti duke përfshirë kryesuesin është tetë (8), prej tyre gjashtë (6) janë të gjinisë mashkullore ose 71% ndërsa dy (2) janë të gjinisë femërore ose 29%, kurse sa i përket përkatësisë etnike shtatë (8) janë shqiptarë ndërsa tre (3) pozita të anëtarëve të PZAP-it, janë të pa plotësuar.

Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të Sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it, është 10 zyrtarë, prej tyre gjashtë (6) janë të gjinisë mashkullore ose 60%, ndërsa katër (4) janë të gjinisë femërore ose 40%, kurse sa i përket përkatësisë etnike nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 10%. Në fund të këtij viti numri i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it, është shtatë (7).



ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa PZAP-i, në bazë të funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP, përveç vendosjes së ankesave dhe apeleve që parashtrihen gjatë procesit zgjedhor, kryen edhe aktivitetet tjera të ndryshme që nuk ndërlidhën me zgjedhje, por me funksionimin e përhershëm dhe të rregullt të institucionit.

PZAP-i, gjatë vitit 2024, ka mbajtur takime/mbledhje të rregullta në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë nxjerr vendime në përputhje me LZP-në, si dhe ligjet tjera të aplikueshme. Janë marrë vendime administrative për çështje të ndryshme që janë në mandatin e institucionit, në kuptim të menaxhimit të gjithmbarshëm të punës së PZAP dhe Sekretariatit.

Vendimet kryesore të marra nga PZAP-i

- Vendimi për miratimin e Planit të Punës së PZAP-it për vitin 2024;
- Vendimi për miratimin e Raportit të Punës së PZAP-it, për vitin 2023;
- Vendim për miratimin e Raportit të PZAP-it, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq.
- Vendim për miratimin e Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave;
- Vendim për emërimin e UD Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së,

PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL I PZAP-IT

Vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve Parlamentare në Republikën e Maqedonisë së Veriut - 08 Maj 2024

Për këtë qëllim, PZAP-i në përfaqësim të 2 (dy) gjyqtarëve dhe 6 (gjashtë) zyrtarë të administratës së sekretariatit të PZAP-it, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve Parlamentare, që janë mbajtur më datë 08 Maj 2024 në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vizita e delegacionit të PZAP-it, u realizua nga data 07-09 maj 2024, pas një ftese nga autoritet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky raport përmbledh observimet e bëra gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të mbajtura më datë 08 Maj 2024. Me datë 7 Maj përfaqësuesit nga PZAP-i, kanë zhvilluar takim me kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, të

cilët u njoftuan me procesin e përgatitjeve për realizimin e Zgjedhjeve Presidenciale dhe Zgjedhjeve Parlamentare, si dhe pritjet nga dita e zgjedhjeve në drejtim të organizimit të zgjedhjeve të lira dhe korrekte. Po ashtu në këtë datë përfaqësuesit e PZAP-it, vizituan edhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u njohën me dinamikën legislative të këtij vendi. Si pjesë e misionit vëzhgues gjatë ditës së Zgjedhjeve me datë 8 Maj 2024, kanë qenë të pranishëm në tre qendra votimi në komunën e Shkupit, për të monitoruar procesin zgjedhor.

Takimi me ekipin e organizatës amerikane Navanti – USAID

Gjatë vitit 2024 është realizuar takimi në mes Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it, me ekipin e organizatës amerikane Navanti-USAID, ku temë e këtij takimi ishte Vlerësimi i Kornizës Strategjike të Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Qeverisjes në shtetin e Kosovës, konkretisht rreth sfidave të sistemit të zgjedhjeve dhe çështjeve aktuale në përgjithësi.

Takimi i PZAP me OSBE

Po ashtu gjatë vitit 2024, është realizuar edhe takimi U.D. Drejtor i Sekretariatit të PZAP-it, me Zyra e Mbikëqyrjes së Brendshme të OSBE-së (MBO) me seli në Vjenë, ku teme e këtij takimi ishte Vlerësimi i mbështetjes së OSBE-së në rajon të proceseve zgjedhore gjatë periudhës 2013-2023.

Takimet e PZAP-it me Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Në mbështetje të nenit 115 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si në vijim: PZAP-i, ka dorëzuar Raportin e PZAP-it, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme në komunat: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq e Vitit 2023.

Janë realizuar edhe takime tjera në mes zyrtarëve të Departamentit Ligjor të KGJK-së dhe PZAP-së, lidhur me finalizimin e Rregullores Nr. 02/2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësorë, Rregulloren Nr.13/2024 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Rregulloren Nr.12/2024, për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimin e Drejtorit të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), si dhe takime lidhur me Planin e Trajnimeve për vitin 2025.

Po ashtu bashkëpunimi me KGJK, lidhur me çështjet e personelit, sidomos për rekrutimin e zyrtareve me kontrate për periudhe të caktuara, për realizimin e projektit për proceset zgjedhore 2025, si dhe hartimi i planit për trajnime për vitin 2025.

PUNËTORITË E PZAP-IT

Me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve të parapara me Planin Vjetor të punës për vitin 2024, PZAP-i, ka organizuar dy punëtori në të cilat kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it, personeli i sekretariatit të PZAP-it, si dhe përfaqësuesit nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Punëtorja e parë është mbajtur nga data 01 deri më datën 04 Mars 2024, në Durrës të Republikës së Shqipërisë, në të cilën është prezantuar dhe shqyrtuar dhe finalizuar, Raporti Vjetor i punës së PZAP-it, për vitin 2023,

Ndërsa punëtorja e dytë është mbajtur në Durrës nga data 26 deri me datën 29 Shtator 2024, në të cilën janë diskutuar dhe finalizuar :

- Ndikimi i reformës së re zgjedhore dhe gjendja në PZAP;
- Plani i veprimit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të datës 09.02.2025;
- Ndryshimet Ligjore, përparësitë dhe sfidat në vendimmarrje;
- Procesi i administrimit të ankesave gjatë procesit zgjedhor;
- Praktikat e marrjes së vendimeve nëpër të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Punëtorja e PZAP-it me Misionin e OSBE-së në Kosovë

Në vazhden e punëtorive të cilat janë organizuar në drejtim të jetësimit të ndryshimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, PZAP-i, ka organizuar mbajtjen e punëtorisë, e cila është financuar dhe përkrahur nga Misioni i OSBE-së, në Kosovë. Kjo punëtori është mbajtur në Pejë nga data 09 deri më datë 12 Dhjetor 2024, në të cilën punëtori është diskutuar dhe miratuar Draft Plani i Punës së PZAP-it për vitin 2025.

Po ashtu në këtë punëtori janë prezantuar dhe diskutuar temat: Votimi jashtë Kosovës – Realizimi ligjor i procesit, skenarët e mundshëm të parregullsive për të cilat parashtrohen ankesat për PZAP, Votimi me Kusht – Risitë ligjore të realizimit të votimit me kusht, Numërimi i Votave në Qendrat

Komunale të Numërimit (QKN) – Realizimi ligjor i procesit të numërimit, Administrimi i pranimit të ankesave dhe dorëzimi i vendimeve të PZAP-it.

AKTIVITETET E SEKRETARIATIT

Gjatë vitit 2024, Sekretariati i PZAP-it, ka mbajtur 12 takime të rregullta, të cilat takime i kanë parapri mbajtjes së takimeve të rregullta të Panelit, ku janë shqyrtuar, diskutuar dhe nxjerr vendime në përputhje me LZP-në, si dhe ligjet tjera të aplikueshme.

Zyrtarët e Sekretariatit kanë përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për mbajtjen e takimeve të PZAP-it, si draft agjendat e takimeve, procesverbalet e takimeve/mbledhjeve të kaluara të PZAP-it, përgatitjen e vendimeve për aprovim në takimet e mbajtur nga PZAP-i.

Në kuadër të hartimit të dokumenteve ligjore dhe strategjike, gjatë kësaj periudhe raportuese, zyrtarët e Sekretariatit, gjegjësisht zyrtarët nga Departamenti Ligjor kanë përgatitur draft Planin e Punës së PZAP-it për vitin 2024, është përgatitur edhe draft Rregullorja për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Draft Rregulloren për Strukturën organizative dhe Klasifikimin e pozitave të Sekretariatit të PZAP-it, Draft Rregulloren për Përzgjedhjen dhe emërimin e drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it, Raporti vjetor i punës së PZAP-it për vitin 2023, Planin Operacional për zbatimin e Planit Strategjik të PZAP-it për vitin 2024, Planin i Veprimit/Aktivitetet Kryesore të PZAP-it për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës për zgjedhjet e 09 shkurtit 2025.

Gjithashtu gjatë këtij viti është përgatitur edhe Raporti për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe për Kuvendet e Komunave Leposaviq dhe Zveçan, Lidhur me këtë proces zgjedhor janë kryer një mori aktivitete: Planin i veprimit, njoftimi i KQZ-së, në lidhje me gjobat e papaguara të subjekteve politike, njoftimi për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrje në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja, etj.²

Gjatë përgatitjes së raportit për këtë proces zgjedhor janë paraqitur 2 apelet e parashtruara kundër vendimeve të KQZ-së, me të cilin njëri apel objekt shqyrtimi kishte mos certifikimin e kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal në Leposaviq nga radhët e subjektit politik LVV, ndërsa apeli tjetër ndaj vendimit KQZ-së, lidhur me certifikimin e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e

² Raporti përmbledhës për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, dhe për Kuvendet e Komunave Leposaviq dhe Zveçan, Lidhur, është dërguar në KGJK dhe është i publikuar në Web të PZAP-ës.

Parakohshme për Kuvend Komunal në Leposaviq. PZAP-i, e ka refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit politik LVV, dhe ka vërtetuar vendimin e KQZ-së.

Ndaj këtij vendimi për certifikim të rezultateve subjekti politik LVV, si palë me interes ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila ka aprovuar si të bazuar ankesën e subjektit politik LVV, ndërsa vendimin e PZAP-it, e kishte kthyer në rivendosje.

PZAP-i, me rastin e rivendosjes duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, në procedurë të rivendosjes ka vendosur që apeli i subjektit politik LVV, të hedhet si i palejuar, pasi që dispozitat ligjore të LZP-së, nuk parashohin të drejtën e ankimit të subjekteve politike pas certifikimit të rezultatit zgjedhor.

Në përputhje me mandatin e tij UD Drejtori i Sekretariatit të PZAP-it, ka marrë vendime për të gjitha çështjet administrative që ndërlidhën me funksionimin e PZAP-it, në kuadër të aktiviteteve të kryera dhe dokumenteve të përgatitura nga zyrtaret e Departamentit Ligjor dhe Departamentit për Financa dhe Shërbime të përgjithshme, në nivel të përgjegjësisë janë nxjerr vendime dhe shkresa tjera nga sekretariati, ndërsa të tjerat janë dërguar për miratim në Panelin e PZAP-it.

- Vendimet për mbajtjen dhe organizmin e punëtorive të PZAP-it brenda dhe jashtë vendit,
- Vendimi për zgjatjen e orarit të punës dhe kompensimit e orëve të punës për zyrtarët e Sekretariatit për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës për zgjedhjet e 09 shkurtit 2025,
- Vendimi për udhëtim zyrtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut lidhur me lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare nga anëtarët dhe personeli i PZAP-it,
- Vendim për shpallje të konkursit për zyrtar të transportit dhe zyrtar të TI si dhe për formimin e komisioneve për pranimin dhe vlerësimin e këtyre zyrtarëve,
- Vendimi për formimin e komisionit për pranimin dhe vlerësimin e zyrtarëve jo permanent për procesin zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025,
- Vendimi për caktimin e zyrtarëve për kryerjen e detyrave shitesë (si zyrtar zotues, zyrtar për regjistrimin e pasurisë,
- Vendimet për plotësim ndryshimet e përvojës së punës për zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-it,
- Vendimi për miratimin lidhur me shfrytëzimin e telefonisë fikse dhe mobile për zyrtarët dhe anëtarët e PZAP-it
- Vendimet për formimin e Komisioneve për pranim të mallit (pajisjeve te TI, formularëve te ankesave etj),
- Vendimet për formimin e Komisioneve për inventarizimin e pasurisë jo financiare, për tjetërsimin e pasurisë jo financiare, si dhe për vlerësimin e pasurisë jo financiare,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kërkesave Buxhetore për vitet 2025-2027,

- Përgatitja dhe dorëzimi në Kuvendin e Kosovës dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, i kërkesës për buxhet shtesë për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2025,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit vjetor financiar 2023, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve -Thesar i Kosovës,
- Përgatitja dhe dorëzimi i kërkesës, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve - Thesar i Kosovës për ekzekutimin e pagave për zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-it me koeficientet e rinj si nëpunës të administratës së drejtësisë në harmoni me ligjin e pagave dhe ligjit për zgjedhje,
- Përgatitja dhe dorëzimi në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Raportit vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm për vitin 2023,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-it) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për vitet 2025-2027,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare të PZAP-it, për vitin 2023, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve etj.
- Përgatitja e shkresës njoftuese/konfirmuese e PZAP-it, për KQZ-në lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike nga zgjedhjet e kaluara për tu certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje,
- Përgatitja e shkresës njoftuese/konfirmuese e PZAP-it, për KQZ-në më të dhënat për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.

PZAP-i, nga fillimi i procesit zgjedhor e deri më 31.12.2024, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, ka pranuar 14 ankesa.

Ankesat e Paraqitura Kundër Vendimeve të KQZ-së, në PZAP

-PZAP-i, ka pranuar 9 ankesa nga përfaqësuesit e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. 01/1305-2024, të datës, 29.08.2024, për miratimin e listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.1/2024 deri Anr.9/2024, të datës 31.08.2024, A.nr.2/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.3/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.4/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.5/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.6/2024 i datës 01.09.2024, A.nr.7/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.8/2024 i datës 31.08.2024, A.nr.9/2024 i

datës 01.09.2024, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.1/2024, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të parashtruara nga ankuesit, Paneli vëren se të njëjtat janë të pa lejuara, duke iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se “PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”, paneli vlerësoi se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së, të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesat janë të palejueshme.

-PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.10/2024, nga Koalicioni politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës, PDAK dhe Lëvizja për Bashkëveprim LPB, me seli në Ferizaj, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos emërimit të anëtareve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve KKZ, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025.

Dispozitat ligjore të nenit 67 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashohin se të drejtë për të nominuar anëtarë të KKZ-ve, kanë vetëm subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor, si dhe nëse kanë fituar ulëse në zgjedhjet paraprake për Kuvendin e Kosovës.

Mbi këtë bazë Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr.01/1641-2024, drejt ka zbatuar dispozitën ligjore, sepse koalicioni PDAK- LPB, nuk ka kaluar pragun zgjedhor dhe nuk ka fituar ulëse në zgjedhjet paraprake për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura në vitin 2021.

-PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.11/2024, nga një votues me vendbanim në Prishtinë, të paraqitur kundër zyrtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me procesin e votimit në qendrën 1925-SH.F.M.U “Ahmet Gashi” për shkak të procesit të ndarjes së votuesve brenda qendrave të votimit, gjegjësisht klasës, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu është referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se “PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.”, dhe në rastin konkret nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen rastet e tilla për ndarjen e votuesve brenda qendrave të votimit, gjegjësisht klasës, andaj paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejuar.

-PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.12/2025, nga subjekti politik Srpska, Lista me seli në Mitrovicë të Veriut, të paraqitur kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt

2025. Sipas rekomandimit të datës 22.12.2024 të Zyrës, është rekomanduar se subjekti politik Srpska Lista, së bashku me kandidatët e këtij subjekti politik i ka plotësuar kushtet ligjore për tu certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 09.02.2025.

KQZ-ja, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ në mbledhjen e mbajtur me datë 23.12.2024, nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës, për certifikimin e subjektit politik në fjalë,

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, qëndrimin dhe përfundimin e KQZ-së, të përshkruar si në njoftimin e datës 23.12.2024, nuk mund ta pranoi si të drejt dhe të ligjshëm një qëndrim të tillë meqenëse i njëjti është në kundërshtim me dispozitat ligjore që i referohen aplikimit dhe certifikimit të subjekteve politike, me konkretisht nenit 16 të LZP-së, i cili përcakton, Kushtet për certifikimin e subjekteve politike të cilat subjektet politike.

PZAP-i, ka anuluar Njoftimin e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), të datës 23.12.2024, dhe ka urdhëruar Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ), ta certifikon subjektin politik Srpska Lista dhe kandidatëve të këtij subjekti politik, sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ të datës 22.12.2024, për Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025.

-PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.13/2025, nga një votues me vendbanim në Toronto, Kanada, parashtruar ndaj vendimit të KQZ-së, me nr. Protokolli 01/2320/2024, datë 30.12.2024, për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, në konsullatën e Kosovës në Toronto, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025,

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, dhe vendimin nr.01/2320-2024 datë 30.12.2024 të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së.

-PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.14/2025, nga një votuese me vendbanim në Gjermani, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, lidhur me mos regjistrimin në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosove, për Zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 09 Shkurt 2025.

Me qenë se pala ankuese nuk ju ka përmbajtur kërkesës së PZAP-it, për plotësimin e ankesës, dhe nuk ka plotësuar ankesën e saj, Paneli bazuar në nenin 10.5 dhe 98 të LZP-së, si dhe nenit 11 paragrafi 9 i Rregullores së PZAP-it 01/2024, ankesën e parashtruesit e konsideroi të tërhequr.

Të gjitha këto vendime të nxjerra nga PZAP-i, janë të publikuara në ueb faqen e PZAP-it, dhe në kopje fizike iu janë dorëzuar palëve.

Ankesat e Paraqitura Kundër Vendimeve të PZAP-it, në Gjykatën Supreme të Kosovës

-Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka bërë ankesë kundër Vendimit të PZAP-it Anr.1/2024 të datës 03.09.2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes ankesës A.A.nr. 37/2024, të datës 06.09.2024, me të cilën ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar të PZAP-it.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pasi që PZAP-i, ka vërtetuar gjendjen faktike plotësisht dhe ka aplikuar drejt ligjin kur ka hedhë të palejuar ankesën e ushtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër vendimit të KQZ-së nr.1/1305/2024 të datës 29.08.2024, i cili vendim ka të bëjë me vendimin për miratimin e listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve, për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09.02.2025.

-Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka bërë ankesë kundër Vendimit të PZAP-it Anr.12/2024 të datës 25.12.2024, në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes ankesës A.A.nr.60/2024 të datës 27.12.2024, me të cilën ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it.

Gjykata Supreme ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pasi që PZAP-i, ka vërtetuar gjendjen faktike plotësisht dhe drejt, dhe ka aplikuar drejt ligjin kur ka aprovuar ankesën e ushtruar nga subjekti politik Lista Serbe, kundër Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrje në Zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Nga njësia e personelit gjatë këtij viti, janë kryer aktivitetet e parapara që i përkasin kësaj njësie, respektivisht aktivitetet në fushën e burimeve njerëzore siç ishin paraparë në Planin e Punës së PZAP-it, për vitin 2024.

- Përditësimi i të dhënave të nëpunësve civil dhe anëtarëve të PZAP-it, në dosjet e tyre personale në mënyrë fizike dhe elektronike përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS),
- Menaxhimi i sistemeve që lidhen direkt me përgjegjësitë e zyrës së personelit, si Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore <https://hrmis.rks-gov.net/>, sistemi i Hyrje -Daljeve <http://smvp.rks-gov.net/>, dhe PAY ROLL - Sistemi i Menaxhimit të Pagave, Sistemi i APK-së për regjistrimin e zyrtareve larte dhe zyrtareve publik (DMSA),
- Përgatitja e raportit vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore, për vitin 2023,
- Përgatitja e listës së zyrtarëve të lartë publik të PZAP-it, dhe zyrtareve publik sipas kërkesës nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, njoftimi i zyrtarëve të lartë publik

dhe zyrtareve publik lidhur me deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë, njoftimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për pranimin e dhuratave për vitin 2023,

- Menaxhimi i formularëve të vlerësimit të performances së zyrtareve për vitin 2023, në HRMIS, dosje fizike dhe elektronike,
- Bashkëpunimi me IKAP, për pjesëmarrjen e personelit të sekretariatit të PZAP-it, sipas ftesave dhe planit kalendarik të IKAP-it,
- Bashkëpunimi me sektorin e listës së pagave, lidhur me formularët e listës së pagave dhe dokumente tjera për anëtarët e larguar dhe anëtarët e emëruar të PZAP-it, dhe çështje tjera të sekretariatit,
- Bashkëpunimi me DMZP/MPB, kërkesat drejtuar DMZP-së, kërkesë për aprovimin e grupit, klasës dhe koeficientin e pagës për stafin e Sekretariatit të PZAP-it, sipas Ligjit Nr. 08/L-228, për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Ligjin e Pagave në Sektorin Publik,
- Përgatitja e Akt emërimeve të reja për zyrtarët e Sekretariatit, pas miratimit të Rregullores Nr. 02/2024, për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Trajnimet e zyrtarëve të Sekretariatit

Personeli i Sekretariatit të PZAP-it, gjatë vitit 2024, ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga:

- Divizioni i Pagave: Trajnim lidhur me Sistemin e Ri të Pagave,
- Agjensioni për Parandalimin e Korrupsionit: Trajnim lidhur me përgatitjen për procesin e deklarimit të pasurisë

Zhvillimi i procedurave të rekrutimit

Në bazë të Planit vjetor për vitin 2024, janë zhvilluar procedurat e rekrutimit të zyrtareve me kontrate për periudhë të caktuar për realizimin e projektit për procesin zgjedhor të Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës 2025, si dhe janë zhvilluar procedurat e rekrutimit për plotësimin e pozitave si Zyrtar për Transport dhe Zyrtar për Teknologji Informative, të cilat pozita nuk kanë qenë të planifikuara në planin vjetor të punës për rekrutim.

Me vendim të KGJK-së, është aprovuar kërkesa e PZAP-it, për rekrutimin e tetëmbëdhjetë (18) pozitave me kontrate për një periudhë të caktuar, me qëllim të realizimit të projektit të caktuar për proceset zgjedhore 2025.

Konkursi për rekrutimin e zyrtarëve me kontratë për një periudhë të caktuar, është shpallur me datën 22.11.2024, në Ueb Faqen e PZAP-it dhe në Tabelën e shpalljeve të PZAP-it, dhe ka mbetur i hapur deri më datën 28.11.2024.

Për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me 9 Shkurt 2024 janë rekrutuar dhjetë (10) zyrtarë të përkohshëm, prej tyre tre (3) Zyrtarë Ligjor, një (1) Zyrtarë për Buxhet dhe Financa, një (1) Zyrtar për Arkiv, një (1) Asistent Administrativ, dy (2) Zyrtar për Futjen e të Dhënave, një (1) Zyrtar për Teknologji Informativ, një (1) Përkthyes.

Kandidatët e përzgjedhur kanë filluar punën me datën 01.01.2025, për të cilët janë përgatitur Kontratë për periudhë të caktuar.

Konkursi për rekrutimin e pozitës Zyrtar për Transport, është shpallur me datë 23.10.2024, dhe ka mbetur i hapur deri me 21.11.2024. Konkursi për rekrutimin e pozitës Zyrtar për Teknologji Informativ, është shpallur me datë 05.11.2024, dhe ka mbetur i hapur 04.12.2024.

U.D. Drejtorit të sekretariatit të PZAP-it Mulë Deskut i është ndërprerë marrëdhënia e punës, sipas fuqisë ligjore, me efekt nga data 18.12.2024 për shkak se i emëruari ka mbushur moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjet.

Aktivitetet nga fusha e prokurimit

Zyrtarja përgjegjëse e prokurimit në PZAP, në bazë të Planit Përfundimtar të Prokurimit, për vitin fiskal 2024, ka kryer disa aktivitete të prokurimit publik, për nevoja të PZAP-it.

- Raporti i Kontratave të nënshkruara për institucionin e PZAP-it, përmes sistemit të E-Prokurimit, për vitin fiskal 2024,
- Përgatitja e Planit Përfundimtar të Prokurimit, për vitin fiskal 2024, përmes sistemit të E-Prokurimit, për institucionin e PZAP-it,
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për shërbime të Sigurimeve të Automjeteve të PZAP-it, (përgatitja dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit),
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për shërbime Shtypja e Formularëve të ankesave në gjuhët zyrtare, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale,
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informativ-10 kompjuter dhe 6 llaptop, për nevojat e PZAP-it
- Lidhja e Kontratës për Sigurimin e Automjeteve të PZAP-it,
- Lidhja e Kontratës për Shtypjen e Formularëve të Ankesave,
- Lidhja e Kontratës për Furnizim me pajisje të TI-ve, 10 kompjuter dhe 6 llaptop,
- Kryerja e të gjitha urdhër blerjeve për të gjitha kontratat e plotfuqishme nga Operatorët Ekonomik (kontratat e lidhura nga AQP).
- Përgatitja e Planeve për Menaxhimin e Kontratave, të lidhura nga Agjencia Qendrore e Prokurimit-AQP, (Furnizim me karige dhe Furnizim me Material të ndryshëm zyrtar,)

Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara

Zyrtari përgjegjës për certifikimin e shpenzimeve financiare gjatë vitit 2024, ka bërë certifikimin e të gjitha shpenzimeve të realizuara financiare për nevojat e PZAP-it, si:

- Certifikimi i shpenzimeve të realizuara për të gjitha kontratat e lidhura me operatorët ekonomik si: (shpenzimet e telefonisë fikse, telefonisë mobile, për ujë të pijshëm, pastrimin e veturave të PZAP-it, për karburante të veturave të PZAP-it, TV kabllor dhe internet, shpenzimet për shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qira)
- Certifikimi i shpenzimeve, për pajisjet e Teknologjisë Informative, (kompjuter dhe llaptopë),
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur për punëtoritë e mbajtura dhe udhëtimet zyrtare të zyrtarëve të sekretariatit dhe anëtarëve të PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur formularët e ankesave,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me blerjet dhe furnizim me material administrativ për PZAP,
- Mbyllja e avanseve dhe petty-cashit për shpenzimet e realizuara,

BASHKËPUNIMI I PZAP-IT, ME AKTERËT E TJERË TË ZGJEDHJEVE

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar në vitin 2020, dhe koordinimit të vazhdueshëm institucional në mes të akterëve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media, janë implementuar të gjitha obligimet e parapara me këtë Memorandum.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve, palë nënshkruese të Memorandumit, është mbajtur takimi i organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me koordinimin e aktiviteteve të gjitha institucioneve për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Kosovës, të datës 09 Shkurt 2025.

Përveç këtij takimi dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it, dhe KQZ-së, ka pasur shkëmbim të informatave lidhur me ankesat e PZAP-it, të para fushatës zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 09.02.2025, njoftimin lidhur me verifikimin e nominimeve të anëtarëve të këshillave të

vendvotimeve dhe anëtarë të komisioneve komunale të zgjedhjeve për Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të datës 09.02.2025, dhe dërgimi i personave të dënuar me vendim të PZAP-it, nga zgjedhjet paraprake.

Po ashtu më datë 27.12.2024, Kryesuesi i PZAP-it dhe UD Drejtori i Sekretariatit të PZAP-it, ka mbajtur takim me Kryetarin e KQZ-së dhe UD Drejtorin e Sekretariatit të KQZ-së, temë diskutimi në këtë takim kanë qenë:

- a) dhënia me prioritet përgjigjeve të PZAP-it, në lidhje me ankesat e parashtruara nga subjektet pulitke,
- b) bashkëpunimi në lidhje me shpërndarjen e formularëve të ankesave në ditën e votimit në për Qendrat e Votimit- mënyrën e shpërndarjes,
- c) lirimi i hapësirave për PZAP-it, referuar pjesës përdhës të objektit në të cilën janë të vendosur 2-3 zyrtare të transportit dhe logjistikës KQZ,
- d) koordinimi dhe bashkëpunimi me akteret zgjedhor, në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit si: Policin e Kosovës, Prokurorin e Shtetit, KGJK, Gjykatën Themelore, lidhur për veprat penale ndaj shkelësve të ligjit dhe rregullave zgjedhor, etj.

Kërkesat për Qasje në dokumente publike

PZAP-i, më datë 17 Janar 2024, ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin për Qasje në Dokumente Publike për vitin 2023, sipas kërkesës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

PZAP-i, më datë 30 Tetor 2024, ka përgatitur dhe dorëzuar Listën e Dokumenteve të PZAP-it, për publikim proaktiv, sipas kërkesës Nr.1028 të datës 18.09.2024, së Agjencisë për Informim dhe Privatësi

PZAP-i, gjatë vitit 2024, nuk ka pranuar dhe protokolluar asnjë kërkesë, që ka të bëjë me Qasjen në Dokumente Publike.

Komunikimi me media dhe informimi publik

Gjatë vitit 2024, PZAP-i, nuk ka pranuar asnjë kërkesë lidhur me ndonjë informatë nga organizatat jo qeveritare apo ndonjë palë e interesuar, kërkesa nga mediat elektronike të shkruara si dhe portalet.

BUXHETI DHE FINANCAT

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa financohet nga Buxheti i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës dhe si i tillë menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë .

Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP, sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga fusha e financave si librat, faturat, raportet e pranimi të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë përmes sistemit të Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës (SIMFK- Free Balance).

Me Ligjin për ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës, Nr. 08/L-260 për vitin 2024, për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, është ndarë buxhet në shumë prej **239,917€**.

Planifikimi buxhetit është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht të zërave duke respektuar legjislacionin financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe në përputhje me strukturën egzistuese të planit kontabël.

Në kuadër të këtij buxheti, planifikimi është bërë për kategori ekonomike si në vijim:

Buxheti në fillim të vitit

Përshkrimi	Buxheti fillestar
Paga dhe shtesa	192,001
Mallra dhe shërbime	46,396
Shpenzime komunale	1,520
Total:	239,917

Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.03/239 të datës 24.12.2024, për kursime buxhetore, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore, për vitin 2024, PZAP-it, në

kategorinë Paga dhe Shtesa, i është zvogëluar buxheti prej 59,610€. Kjo tepricë buxhetore është krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të disa anëtarëve të PZAP-it dhe nuk ka qenë paneli i kompletuar gjatë vitit 2024.

Gjithashtu në buxhetin e mbetur ka ndikuar edhe rekomandimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit lidhur me pagat e anëtarëve të PZAP-it, ku anëtarët e PZAP-it deri në muajin korrik 2024 janë paguar me pagë sekondare të gjyqtarit, ky rekomandim është zbatuar dhe si rezultat nga muaji korrik kryesuesi dhe anëtarët e PZAP- pagat i marrin 30% te pagës se Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it për kryesuesin e PZAP-it dhe 20% e pagës se Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it për anëtarët, ku shuma totale e pagës se tyre është më e vogël se sa paga sekondare e gjyqtarit.

Poashtu, në shumen totale e kësaj teprice buxhetore ka ndikuar edhe pushimi pa pagesë për një vit për pozitën e zyrtarit të TI-së.


Buxheti me ndryshime

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti i ndryshuar	Buxheti final
Paga dhe shtesa	192,001€	-59,610€	132,391€
Mallra dhe shërbime	46,396€	-	46,396€
Shpenzime komunale	1,520€	-	1,520€
Total:	239,917€	-59,610€	180,307€

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it, në vlerë prej 180,307€ si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre :

- 73.43 %, e fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe shtesa,
- 25.73 %, e fondeve është akorduar për shpenzime, mallra dhe shërbime,
- 0.84 %, për shpenzimet komunale ,

STRUKTURA E BUXHETIT PËR VITIN 2024



Shpenzimet buxhetore

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2024, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për PZAP, dhe buxheti është shpenzuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara në vitin 2024, PZAP-i, ka shpenzuar 173,111€, apo 96% e buxhetit final.


Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Përshkrimi	Shuma
Paga dhe shtesa	132,390€
Mallra dhe shërbime	40,594€
Shpenzime komunale	127€
Total:	173,111€

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e mbetur pas shkurtimeve është 96%.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është paraqitur në tabelën më poshtë.

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Ndryshimi	Realizimi në %
Paga dhe shtesa	132,390	132,390	-	100%
Mallra dhe shërbime	46,396	40,594	5,802	87%
Shpenzime komunale	1,520	127	1,393	8.35
Total:	180,306	173,111	7,195	96%



Në kategorinë e pagave dhe shtesave gjatë vitit janë shpenzuar 100% e buxhetit total të pagave, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është shpenzuar 87% e buxhetit, si dhe në kategorinë e shërbimeve komunale është shpenzuar 8.35% e buxhetit për këtë kategori.

Në tabelat në vijim pasqyrohen shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat	Shuma
Pagat neto	110,419
Tatimi në të ardhura personale	9,363
Kontributi pensional i punëdhënësit	6,304
Kontributi pensional i të punësuarve	6,304
Gjithsej	132,390

Nga kategoria e pagave dhe shtesave buxheti u shpenzua në shumë prej 132,390.31€, çka do të thotë se buxheti është shpenzuar 100%.

Mallrat dhe shërbimet


Mallrat dhe shërbimet	Shuma
Mëditjet për udhëtime zyrtare brenda vendit	480
Akomodimi për udhëtime zyrtare brenda vendit	935
Mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	5,499
Akomodimi për udhëtime zyrtare jashtë vendit	5,535
Shpenzime tjera të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	369
Shpenzimet për internet	558
Shpenzimet e telefonisë mobile	5,555
Regjistrimi i automjeteve	150
Taksa komunale	20
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	406
Shërbime shtypjes/printimit	892
Pajisjet e trafikut	55
Mobileje (me pak se 1000 euro)	761
Kompjuterë më pak se 1000 euro	11,590

Softuerët-licencat dhe mirëmbajtja e tyre	89
Qiraja për pajisje	970
Furnizime për zyre	947
Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	159
Karburante për vetura zyrtare	838
Sigurimi i automjeteve	917
Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	3,869
Mallra dhe shërbime	40,594

Siç shihet nga tabela më lartë, shuma e mjeteve të shpenzuara për këtë kategori të shpenzimeve është 40,594€ apo 87.5%.


Shpenzimet komunale	
Shpenzimet komunale	Shuma
Shpenzimet e telefonisë fikse	127
Gjithsej	127

Nga kjo kategori buxheti u shpenzua në shumë prej 127€ apo 2.8%, ky buxhet u shpenzua vetëm për shpenzimet e telefonisë fikse.



Krahasimi i shpenzimeve të buxhetit përgjatë dy viteve 2023-2024

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	%
2024			
Paga dhe shtesa	132,390	132,390	100%
Mallra dhe shërbime	46,396	40,594	87%
Shpenzime komunale	1,520	127	8.35
Gjithsej	180,306	173,111	96%
2023			
Paga dhe shtesa	157,218	157,218	100%
Mallra dhe shërbime	50,000	34,030	68%
Shpenzime komunale	7,820	142	1.82%
Shpenzimet kapitale	9,000	4,376	49%



Nëse e bëjmë një krahasim të shpenzimit të buxhetit të vitit 2023 me buxhetin e vitit 2024 shihet një dallim i vogël se në vitin 2024, buxheti është shpenzua diku rreth 9% më shumë se në vitin 2023.

TË HYRAT E PZAP-IT

PZAP-i, në bazë të nenit 120 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-288, LZP, mund të shqiptoj gjoba ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, në rast se përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së.

PZAP-i, gjatë vitit 2024, nuk ka shqiptuar asnjë gjobë ndaj subjekteve politike.

Realizimi i të hyrave

Gjatë viti 2024, është realizuar (inkasuar) vetëm një e hyrë në vlerë prej 244€ ndaj vendimit të PZAP-it Anr.27/2014, e cila gjobë është shqiptuar në vitin 2014, ndaj një kandidati të pavarur dhe kjo gjobë është realizuar me Urdhër Përmbartimor gjatë vitit 2024.

PZAP –i, ka realizuar te gjitha borxhet që Subjektet Politike i kanë pasur dhe nuk ka borxhe të paguara.

Gjatë vitit 2024 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it, ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 244 €, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Kosovës.

Aktivitetet tjera nga financat

- Përgatitja e Kesh Planit të buxhetit për programet e PZAP-it, i cili planifikim (Kesh Plan) duhet të ndërlihet direkt në SIMFK. Planifikimi (zotimi) i buxhetit bëhet në kuartale (çdo tre muaj) për kategori ekonomike sipas ndarjeve buxhetore të Ligjit të Buxhetit dhe planin e shpenzimeve në baza mujore për vitin 2024 si dhe është zbatuar procedura për fillimin e alokimit të buxhetit për vitin 2024;
- Ekzekutimi i buxhetit të PZAP-së sipas ndarjeve buxhetore më Ligjin Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024;
- Përgatitja e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025 – 2027, drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Planifikimi i buxhetit 2025 – 2027 dhe vlerësimet për vitet 2026-2027 sipas qarkoreve buxhetore 2025/01 dhe 2025/02 si dhe është bërë përgatitja e kërkesave për buxhet shtesë për vitin 2025 drejtuar Presidencës, Kuvendit, Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Regjistrimi i transaksioneve në regjistrin e Kontabilitetit të Thesarit (SIMFK), si dhe mbajtja e evidencës kontabël në formatin e raportimit sintetik dhe analitik të PZAP-së;
- Regjistrimi i pasurisë mbi 1000€ në SIMFK dhe i pasurisë nën 1000€ në sistemin E-pasuria;
- Përgatitja e raporteve për procesin e pajtueshmërisë së regjistrave kontabël në SIMFK dhe regjistrave kontabël të PZAP-së, përkatësisht barazimi mujor i të hyrave dhe shpenzimeve për Thesarin në MFPT;
- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare të PZAP-së për vitin 2024;
- Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA, për vitin 2023, si dhe përgatitja e raportit periodik të progresit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit 2023;
- Raporti Vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm-Pytësori si dhe Regjistri i Rreziqeve drejtuar Njësia Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Rekomandimet e auditimit të pasqyrave financiare të PZAP-it

Sipas konkluzionit të ZKA-së, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të PZAP-së, kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar – PZAP-in në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Rekomandimet e ZKA-së në raportin e pasqyrave financiare të PZAP-it, të vitit 2023, të cilat janë zbatuar gjatë vitit 2024 janë:

1. Sekretari i PZAP-së duhet të sigurojë se shtesa/shpërblimi i kryesuesit dhe anëtarëve të panelit të PZAP-it të kategorizohet në përputhje me ligjin e pagave në sektorin publik.

PZAP-i, më qëllim të zbatimit të rekomandimit të ZKA, dhe materializimit të nenin 12, paragrafi 3, i Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me datën 11.06.2024, ka kërkuar nga KGJK, që të nxjerrë vendim për caktimin e pagës sekondare të kryesuesit dhe anëtarëve të PZAP-it.

PZAP-i, nga KGJK, ka pranuar përgjigjen Nr. 09/16/7 të datës 03.07.2024, dhe në përgjigje është kërkuar nga UD Drejtori i sekretariatit të PZAP-it, që të zbatoj ligjin dhe rekomandimet e dhëna nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.

PZAP-i, ka përgatitur dhe përmes e-mali me datën 10.07.2024, ka dërguar në Divizionin e Pagesave – Thesar, MFPT Formularët e pagesave për pagesën e pagës sekondare për kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it, duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L- 196, për Pagat në Sektorin Publik, neni 12.3 i këtij ligji, Rregulloren (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtese, neni 7 i kësaj rregullore, rekomandimin e ZKA-së, dhënë në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, Nr. 895 i datës 19.06.2024 dhe përgjigjen Nr. 09/16/7 të datës 03.07.2024, të lëshuar nga KGJK.

Ky rekomandim i dhënë nga ZKA, është zbatuar nga PZAP-i.

2. Sekretari i PZAP-së duhet të sigurojë se para se të merret vendimi për emërim të komisioneve dhe menaxherëve të kontratës, të merren parasysh parimet për ndarjen e detyrave.

Sa i përket kësaj të gjeture në fjalë se zyrtari i cili ishte anëtar i komisionit të vlerësimit, i njëjti ishte caktuar edhe menaxher i kontratës., kjo është bërë për arsye se ndarja e përgjegjësiave dhe detyrave ka qenë si rezultat i numrit të vogël të stafit, të cilin aktualisht e posedon PZAP-i.

Ky rekomandim i dhënë nga ZKA, është zbatuar nga PZAP-i.

3. Sekretari i PZAP-së, duhet të sigurojë që para përgatitjes së PFV-ve, aplikohet zhvlerësimi për të gjitha pasuritë, si dhe të gjitha pasuritë e blera regjistrohen në planin kontabël, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV për vitin 2024, të jetë i plotë dhe i saktë.

Ky mos regjistrim ka ndodhur për arsye se zyrtari përgjegjës për regjistrim të pasurisë ka qenë në shfrytëzim të pushimit një (1) vjeçar pa pagesë, nga muaji dhjetor 2023, dhe PZAP-i, nuk kishte zyrtar zëvendësues të certifikuar (trajnuar) në këtë fushë. PZAP-i, ka adresuar kërkesën në Thesar

për trajnim, mirëpo në kohën kur është dashur të regjistrohet pasuria sipas afateve ligjore nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Thesari, për trajnimin e zyrtarit. Lidhur me këtë çështje tani më nuk ekziston rreziku i humbjes apo i keq menaxhimit të pasurisë.

Ky rekomandim i dhënë nga ZKA, është zbatuar nga PZAP-i.

ZKA, është në fazën përfundimtare të auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të PZAP-it për vitin 2024, por ende nuk e ka nxjerr/finalizuar Raportin e auditimit të PZAP-it, për vitin financiar 2024.

Shërbimet e përgjithshme

Në kuadër të Departamentit për Financa dhe shërbime të përgjithshme janë edhe aktivitetet nga logjistika, teknologjia informative, përkthimet dhe nga transporti.

Logjistika - Njësia e logjistikës ofron mbështetje të vazhdueshme për të gjithë stafin e PZAP-së, si: pranimin e mallit në depo, pranimet e nevojshme që duhet të kryhen rregullisht në bazë të procesit të realizimit të pagesave, kontrollimi i inventarit në depo ku për ç'do fund vit bëhet regjistrimi i të gjithë inventarit dhe i materialit administrativ që janë në depo dhe inventarit që është në posedim, regjistrimi i inventarit në sistemin E-Pasuria dhe SIMFK, ngarkimi i zyrtarëve me material administrativ sipas kërkesës së zyrtarëve, ngarkimi dhe shkarkimi i depos si dhe detyra tjera sipas kërkesave të zyrtarëve. Në çdo fund vit nxjerrën vendimet për formim të komisioneve për inventarizim, vlerësim dhe tjetërsim të pasurive të cilat përgatisin raportin e inventarizimit, vlerësimit dhe tjetërsimin e pasurisë.

Teknologjia Informative - Në funksion të përmbushjes së detyrave që ndërlidhen me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve nga teknologjia informative, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme sipas kërkesave të zyrtarëve. Në kuadër të aktiviteteve më kryesore nga kjo njësi, është mirëmbajtja dhe azhurnimi në vazhdimësi i Ueb faqes së PZAP-it, dhe rrjeteve sociale, ku gjatë kësaj periudhe vjetore janë publikuar vendime, formularë, udhëzime, Raporti Vjetor i Punës, Plani Vjetor i Punës së PZAP-it, dhe informacione tjera që kanë qenë të dobishme për Institucionin.

Në vazhdimësi është bërë ofrimi i përkrahjes teknike për Sistemin për Menaxhimin e Ankesave (SMA), ku gjatë vitit 2024, është bërë ridizajnimi i ueb aplikacionit të këtij sistemi, si dhe për Teknologjinë Informative në përgjithësi. Nga kjo njësi janë përgatitur specifikat për furnizime sipas kërkesave të njësive përkatëse, furnizim me inventar për zyre, pajisje të teknologjisë informative, sigurimin e automjeteve zyrtare, dizajnimin e webfaqes zyrtare të PZAP-it. Njësia e Teknologjisë Informative ka bërë planifikimin, administrimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e TI-së dhe aplikacioneve të Microsoft të ofruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe mirëmbajtjen dhe administrimin e Ueb faqes dhe Sistemit për Menaxhimin e Ankesave, domain-it (rrjetin e brendshëm), identifikimi i nevojave të PZAP-it, për softuer të licencuar për vitin 2024.

Përkthimet – Nga njësia e përkthimeve, janë kryer të gjitha obligimet e dala nga PZAP/SPZAP, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Janë përkthyer të gjitha dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it si: përkthimi i Raportit Vjetor të punës-2023; Planit të Punës - 2024 përkthimi i agjendave dhe procesverbaleve të takimeve të PZAP-it dhe të Sekretariatit të PZAP-it, gjitha njoftime për publikun të publikuara në web faqen zyrtare të PZAP-it, përkthimi simultan dhe konsektiv gjatë takimeve të mbajtura të PZAP-it si dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesës së zyrtarëve të Institucionit

Transporti – PZAP-i, ka në pronësi dy makina zyrtare që shfrytëzohen për kryerjen e aktiviteteve zyrtare të Institucionit.

Automjetin e Tipit: Mitsubishi Outlander me Targa të Regjistrimit 5Z-101-17 dhe,

Automjetin e Tipit: Ford Focus, me Targa të Regjistrimit 5Z-102-17.

Tabela e pasqyrimit të shpenzimeve në KM dhe Karburante në litër për vitin 2024

Automjetet	KM	Litra	KM	Litra	KM	Litra	KM	Litra	KM	Litra
	Jan. - Mars 2024	Jan. - Mars 2024	Prill -Qersh. 2024	Prill -Qersh. 2024	Korr. - Shtat. 2024	Korr. - Shtat. 2024	Tetor - Dhjet. 2024	Tetor - Dhjet. 2024	Jan. - Dhjet. 2024	Jan. - Dhjet. 2024
Ford	1039	69.5	624	33.69	755	47.11	232	23.57	2650	173.87
Mitsubishi	905	97	347	0.00	1417	109.13	284	41	2953	227
Gjithsejt:	1944	166.5	971	33.69	2172	156.24	516	64.57	5603	400.87

Me qëllim të realizimit / përmbushjes së aktiviteteve PZAP-i, ka organizuar dy punëtori jashtë vendit në Republikën e Shqipërisë, dhe për shkak se nuk ka pas në dispozicion automjete të mjaftueshme për organizmin dhe përkrahjen logjistike të këtyre dy ngjarjeve ka huazuar dy (2) automjetet e nevojshme nga KGJK dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës, ku shpenzimet e derivateve janë mbuluar nga PZAP-i.

Përpos këtyre aktiviteteve nga transportit janë kryer edhe punë tjera si: përcjellje e vazhdueshme e veturave për servise jo të rregullta, ndreqjen e ndonjë defekti akut, është bërë servisi i rregullt i veturave, pastrimin e veturave sipas nevojës, shërbimet me transport sipas kërkesave të Kryesuesit, anëtarëve të Panelit si dhe zyrtarëve të SPZAP-it, shpërndarja e dokumenteve të ndryshme nëpër Institucione si dhe punë të tjera.

SFIDAT

- Në mungesë të buxhetit, Sekretariati i PZAP-ës nuk ka mundur të zbaton Rregulloren Nr.13-2024 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me të cilën rregullore janë paraparë edhe 7 pozita të reja.
- Mos aprovimi i buxhetit shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës në kategorinë mallra dhe shërbime, Sekretariati i PZAP-ës nuk ka mundur të zbaton vendimin e KGJK për rekrutimin e 18 pozitave (por vetëm 10) për staf të përkohshëm për zgjedhjet e mbajtura me 9 shkurt 2025.
- Hapësirat e punës së PZAP-ës. PZAP është vënë në vështirësi në realizim të mandatit ligjor për shkak të hapësirave tejet të vogla, përfshirë kushtet për ngrohje dhe klimatizim. Kjo është me sfida, paqësisht gjatë mbajtjes së paneleve të rregullta, dhe shqyrtimit të ankesave në proces zgjedhor, shtuar këtu edhe obligimin ligjor të mbajtjes së seancave publike, si përgjegjësi e re ligjore, Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.